



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FIER

Nr. 939 Prot

Fier, më 09/07/2026

LËNDA: THIRRJE PËR PROPOZIME PROGRAMORE DHE MEDIATIKE

Për realizimin e një fushate mediatike promovuese të vlerave, trashëgimisë dhe zhvillimit të Bashkisë Fier

AUTORITETI KONTRAKTUES
Bashkia Fier

Në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, akteve nënligjore në zbatim të tij, si dhe në funksion të promovimit të vlerave historike, kulturore, turistike dhe zhvillimore të territorit, **Bashkia Fier** shpall këtë thirrje publike për paraqitjen e propozimeve programore dhe mediatike nga subjektet audiovizive dhe televizionet lokale.

Qëllimi i kësaj nisme është realizimi i një fushate mediatike profesionale për promovimin e identitetit, trashëgimisë, potencialeve dhe zhvillimit të Bashkisë Fier, nëpërmjet një serie emisionesh televizive informuese dhe promovuese.

OBJEKTI I THIRRJES

Realizimi, prodhimi dhe transmetimi i një cikli prej deri në **10 (dhjetë) emisionesh televizive promovuese**, me fokus në:

- Turizmin;
- Artin dhe kulturën;
- Historinë;
- Trashëgiminë kulturore dhe arkeologjike;
- Zhvillimin ekonomik;
- Zhvillimin bujqësor;
- Infrastrukturën dhe investimet publike;
- Mjedisin dhe zhvillimin e qëndrueshëm;
- Rininë, sportin dhe arsimin;
- Tema të tjera me interes publik për komunitetin e Bashkisë Fier.

FONDI LIMIT

Fondi limit i vënë në dispozicion për realizimin e kësaj fushate mediatike është:

450,000 (katërqind e pesëdhjetë mijë) lekë, me TVSH.

AFATI I REALIZIMIT

Fushata mediatike dhe transmetimi i emisioneve do të realizohen brenda afateve që do të përcaktohen në marrëveshjen që do të lidhet me subjektin e përzgjedhur.

KARAKTERISTIKAT E EMISIONEVE

Subjektet e interesuara duhet të paraqesin një koncept programor dhe teknik që përmbush kriteret e mëposhtme:

1. Format i emisionit

- Kohëzgjatja e çdo emisioni deri në 40 minuta.
- Realizimi në studio televizive profesionale.
- Pjesëmarrja e përfaqësuesve të Bashkisë Fier, specialistëve të fushës, studiuesve, ekspertëve dhe personaliteteve sipas tematikës.

2. Reportazhi tematik

- Çdo emision duhet të përmbajë një reportazh të dedikuar me kohëzgjatje deri në 15 minuta.
- Reportazhi duhet të realizohet në terren dhe të promovojë vlerat, asetet dhe potencialet e Bashkisë Fier.

3. Intervistat

Reportazhet duhet të përfshijnë intervista me:

- qytetarë;
- specialistë të fushës;
- studiues;
- artistë;
- sipërmarrës;
- përfaqësues institucionesh;
- personalitete të njohura të qytetit dhe zonës.

4. Standardet editoriale

- Emisionet duhet të konceptohen, përgatiten dhe drejtohen nga gazetarë profesionistë me përvojë në median audiovizive.
- Përmbajtja duhet të jetë informative, objektive dhe në përputhje me interesin publik.
- Të respektohen standardet etike të gazetarisë dhe legjislacioni në fuqi për mediat audiovizive.
- Të ruhet dhe promovohet imazhi institucional i Bashkisë Fier dhe interesi i komunitetit fierak.

5. Standardet teknike

- Filmimet duhet të realizohen me cilësi profesionale jo më të ulët se Full HD.
- Regjistrimi audio të kryhet me pajisje profesionale.
- Montazhi duhet të përfshijë elementë grafikë, titra, identitet vizual dhe elementë promovues të Bashkisë Fier.
- Kur kërkohet nga tema, të përdoren filmime ajrore me dron dhe teknika të tjera bashkëkohore të prodhimit audioviziv.
- Materialet finale duhet të jenë të përshtatshme për transmetim televiziv dhe publikim në platformat digjitale.

6. Promovimi dhe shpërndarja

- Emisionet duhet të transmetohen në televizionin realizues sipas një kalendari të dakordësuar me Bashkinë Fier.
- Të sigurohet promovimi i tyre në rrjetet sociale, faqet zyrtare dhe platformat digjitale të subjektit realizues.
- Materialet duhet të jenë të përshtatshme për përdorim nga Bashkia Fier në kanalet e saj të komunikimit publik.

7. Interesi publik

Përmbajtja e emisioneve duhet:

- të promovojë vlerat historike, kulturore, turistike dhe ekonomike të territorit;
- të kontribuojë në informimin e publikut;
- të respektojë interesat publike të Bashkisë Fier dhe komunitetit fierak;
- të mos përmbajë elemente politike, elektorale apo propagandistike.

8. Të drejtat e autorit dhe pronësia e materialeve

- Të gjitha materialet audio-vizive të realizuara në kuadër të kësaj fushate do të jenë pronë e Bashkisë Fier.
- Bashkia Fier gëzon të drejtën e përdorimit, publikimit, transmetimit, arkivimit dhe ripërdorimit të tyre pa kufizime kohore apo territoriale.
- Subjekti realizues është i detyruar të dorëzojë pranë Bashkisë Fier materialet e përfunduara, si dhe materialet e papërpunuara (raë footage), në format digjital.

DOKUMENTACIONI I KËRKUAR

Subjektet e interesuara duhet të paraqesin:

1. Kërkesë për pjesëmarrje;
2. Ekstraktin e regjistrimit të subjektit;
3. Licencën ose dokumentacionin përkatës për ushtrimin e aktivitetit mediatik;
4. Portofolin e punëve të ngjashme të realizuara;
5. Konceptin programor të emisioneve;
6. Përshkrimin e ekipit realizues;
7. Planin e realizimit dhe transmetimit;
8. Ofertën financiare.

KRITERET E VLERËSIMIT

Ofertat do të vlerësohen sipas sistemit të mëposhtëm të pikëzimit:

Kriteri	Pikët
Cilësia e konceptit programor dhe qasja promovuese	40
Eksperienca në realizimin e emisioneve dhe reportazheve të ngjashme	25
Kapacitetet profesionale dhe teknike të ekipit realizues	20
Strategjia e transmetimit dhe promovimit mediatik	5
Oferta financiare	10
Totali	100

Bashkia Fier rezervon të drejtën të kërkojë informacion ose dokumentacion shtesë gjatë procesit të vlerësimit.

DORËZIMI I OFERTAVE

Ofertat dhe dokumentacioni përkatës duhet të dorëzohen pranë **Bashkisë Fier** brenda afatit të përcaktuar në njoftimin zyrtar të publikuar në faqen e institucionit.

Vetëm subjektet e përzgjedhura do të njoftohen për fazat e mëtejshme të procedurës.

Konceptoi: *Ardjana Mile*



KRYETARI

ARMANDO SUBASHI

